



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. _____ prot

Përmet më, _____._____.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT PROCEDURË E HAPUR -PUNË, PROKURIM ELEKTRONIK

OBJEKTI I PROCEDURËS: Rikonstruksion i Rrugës Qilarisht

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45112000-5 - Punime gërrmimi, 45210000-2 - Punime ndërtimi, 45233140-2-Punime rrugore, 45233222-1 - Punime shtrimi dhe asfaltimi, 34992200-9 - Sinjalistikë rrugore

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **65 627 871,38** (gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e një presje tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Përmet** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.
- c. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26 dhe 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021, 2022 dhe 2023** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe te ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: **2021, 2022 dhe 2023**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i

ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c (Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, **për vitin 2024**. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për këto vite, sipas të dhënave të QKB-së).

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe neni 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pese viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Dhe çdo lloj dokumenti tjetër që provon realizimin me sukses të punëve;
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

-Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe Prokurën e posaçme, të deklaruara në fazën e tenderimit.

-Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

NP – 1 A (Punime gjurmimi në tokë)

NP – 4 C (Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale)

NP – 7 A (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje)

NP – 11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.)

NP – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit.)

Për punimet speciale të ndërtimit:

NS – 1 A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

NS – 6 A (Sinjalistikë rrugore jondriçuese)

NS – 7 A (Barierra dhe mbrojtje rrugore)

NS – 18 A (Punime topogjeodezike)

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar lidhja 2,3 dhe 4.*

Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 1	Punime gjurmimi në tokë	<ul style="list-style-type: none"> - Gjurmim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m³, në kanale gjeresi > 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet - Gjurmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 3 - Gjurmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale gjeresi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet - Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km 	A (0 – 20 milion lekë)	3 036 499
NP – 4	Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, dhe pista aeroportuale	<ul style="list-style-type: none"> -Ndërtim kasonete në tokë mesatare - Shtresë stabilizant t=15cm - Shtresë stabilizant t=10cm - Mbushje me çakelli gur gurorë në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri - Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makineri - Shtresë çakelli mbeturinë kave t=15cm, përhapur e ngjeshur me makineri - FV Bordura betoni 20x35 cm - Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka - F V bordura betoni 12x25cm - Shtresë binderit me granit gur kave,5cm,me makineri 	C (50-100 milion lekë)	57 130 900

		<ul style="list-style-type: none"> - Shtresë asfaltbetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri - Struktura monolite betoni C 12/15 (2) - F V hekur betoni periodik $\varnothing > 12$ mm -Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m - Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m - Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m - Mbushje me argjile pas mureve - Mbushje me zhavorr pas mureve -Nenshtrese zhavorri -Shtrese rere -Shtrese betoni C 16/20 -Struktura monolite betoni C 12/15 - Struktura monolite betoni C 16/20 - Struktura monolite betoni me çakëll C 20/25 -F-V hekur betoni i zakonshem \varnothing 6-10 mm 		
NP – 7	Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje	<ul style="list-style-type: none"> -F.V tuba betoni \varnothing 400 mm -F.V tuba b/a \varnothing 800 mm -F.V tuba b/a \varnothing 1000 mm -Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize -Furnizim, vendosje tuba plastmasi \varnothing 80 -F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm 	A (0 – 20 milion lekë)	635 312
NP – 11	Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	<ul style="list-style-type: none"> - Spostim shtylle elektrike (Cmontim dhe montim shtylle elektrike prej betoni perfs hire linjat dhe aksesoret) 	A (0 – 20 milion lekë)	36 396

NS – 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	-Prishje struktura prej betoni -Prishje struktura prej guri	A (0 – 20 milion lekë)	215 446
NS – 6	Sinjalistika rrugore jondriçuese	- Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor me gjerësi 15 cm. Termoplastike (sprajt) - Vijëzimet me boje bikomponente - F.v. Tabela trekëndore e vogël me A = 60 - F.v. Tabelë rrethi “detyrim” e vogël me D=40 - F.v. Tabelë rrethi “ndalim” e vogël me D=40 -F.v Pervijues kthese e ngushte ose e forte (ne forme T) -F.v Sinjalet e drejtimit urban HxL normal 25x125 -F.v Tabela trekendore e vogël me A-B, 60-20	A (0 – 20 milion lekë)	1 358 594
NS – 7	Barierra dhe mbrojtje rrugore	F.V guardrail - N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W4	A (0 – 20 milion lekë)	1 303 233

NS-18 A (Punime topogjeodezike) - Kjo pikë e licencës është kërkuar për shkak se kemi të bëjmë me infrastrukturë rrugore dhe projekti parashikon përmirësimin e gjeometrisë horizontale dhe vertikale të rrugës. Piketimi dhe kontrolli topografik duhet bërë në çdo faze të zbatimit të punimeve.

NP – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit) - objekti shtrihet në kufirin e dy zonave të mbrojtura Parkut kombëtar të Bredhit të Hotoves nga ana lindore dhe në perëndim nga parku kombëtar i lumit Vjose dhe për këtë arsye duhet kujdes në kryerjen e punimeve në aspektin mjedisor.

2.3.3 Operatori/ët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt** i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, si dhe duhet të ketë minimumi 10 vite eksperience pune. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

(Në rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e

shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, **te përfshirë në licencën e shoqërisë**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diploma universitare, librezë pune si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxh. në profilet e ndërtimit (Inxhinier Ndërtimi)
- 1 (një) Inxh. në profilet e ndërtimit (Inxhinier Hidroteknik)

- 1 (një) Inxh. Elektrik
- 1 (një) Inxh. Topograf/ Gjeodet/Markshajder
- 1 (një) Inxh. Mjedisi

Minimalisht njëri nga drejtuesit e mësipërm të jetë i pajisur me **licensë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri dhe formimi profesional i inxhinierëve që përbëjnë stafin kryesor teknik, është përcaktuar duke u nisur nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Kjo kërkesë është përcaktuar pas analizimit që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet edhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në licencën profesionale të shoqërisë. Duke parë dhe marrë në konsideratë kompleksitetin e punimeve që do të realizohen, referuar këtu projekt-preventivit të zbatimit, është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit të tij, inxhinierët e kërkuar në këtë pikë, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP-1, NP-4, NS-1, NS-6, NS-7
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP-7
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP-11
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NS-18

- **Inxhinieri Mjedisit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë NP – 12

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoresh prej minimalisht **40 (dyzetë) punonjës** të pasqyruar në listëpagesen e muajit të fundit. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.4 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtoresh të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve që duhet të ketë shoqëria ofertuese, janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet, orët e punës, zërat, kategoritë dhe kompleksiteti i punimeve, kualifikimi i punonjësve (ku përfshihet stafit organizativ, administrativ, tekniko-inxhinierik dhe ai mbështetës), grafiku i punimeve dhe shpërndarja e kantierit etj. Vendosja e këtij kriteri është teknikisht i argumentuar, pasi i përgjigjet përmasave të kontratës që prokurohet si për nga fondi limit, kohështrirja, por edhe për nga natyra e punimeve duke marrë në analizë manualin teknik të punimeve të ndërtimit në fuqi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje minimalisht muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen e kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtoresh të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës dhe Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtoresh si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve, mbështetur në

Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Nr	NR.ANLZ	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ORET E PUNES PUNTORI	SHUMA ORE PUNTORI	ORET E PUNES MAKINERI	SHUMA ORE MAKINERI
1	2	3	4	5	6	7	8	9
1. PUNIME GERMIMI								
1	3.98/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	3114.0	0	0	0.078	242.892
2	3.124/1a	Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir 3	m3	150.0	0	0	0.520	78
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	4665.0	5	23325	0	0
4	3.98/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	1321.0	0	0	0.086	113.606
Shuma 1:						23325		434.498
2. PUNIME SHITESH								
5	3.179	Ndertim kasonete ne toke mesatare	m2	1064.0	3.66	3894.24	0.0000	0
6	3.164/1b	Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri	m3	938.0	0.34	318.92	0.1400	131.32
7	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	10535.0	0.28	2949.8	0.2650	2791.775
8	3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	10006.0	0.1	1000.6	0.0850	850.51
9	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	1660.0	0.075	124.5	0.0730	121.18
10	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	2128.0	0.21	446.88	0.2625	558.6
Shuma 2:						8734.94		4453.385

3. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME								
11	3.405/1	Prishje struktura prej betoni	m3	78.0	1.75	136.5	1.550	120.9
12	3.405	Prishje struktura prej guri	m3	5.0	1	5	0.250	1.25
13	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	6.0	5.6	33.6	0.000	0
14	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	9.0	5.3	47.7	0.000	0
15	3.333	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m	m3	12.0	5.1	61.2	0.000	0
16	3.396/2	Mbushje me argjile pas mureve	m3	71.0	0.4	28.4	0.040	2.84
17	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve	m3	474.0	0.04	18.96	0.040	18.96
Shuma 3:						331.36		143.95
4. PUNIME ASFALTIMI								
18	3.222/1	Shtrese binderi me granil gur kave,5cm,me makineri	m2	7696.0	0.109	838.864	0.021	161.616
Shuma 4:						838.864		161.616
5. PUNIME SHITRES ASH 2								
19	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	197.0	2.9	571.3	0	0
20	2.261	Shtrese rere	m3	1.0	2.175	2.175	0	0
21	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	3.0	8.6	25.8	0.730	2.19
Shuma 5:						599.275		2.19
6. UJES JELLES E KANALIZIM I JASHEM								
22	2.554	F.V tuba betoni Ø 400 mm	ml	3.0	2.1	6.3	0	0
23	2.557	F.V tuba b/a Ø 800 mm	ml	17.0	3.7	62.9	0.240	4.08
24	2.558	F.V tuba b/a Ø 1000 mm	ml	6.0	5	30	0.240	1.44
25	2.342	Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	copë	2.0	5.6	11.2	1.500	3
Shuma 6:						110.4		8.52
7. PUNIME BETONI E BETONARMEJE								
26	3.235	Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% g	m3	32.0	10.8	345.6	0.960	30.72
27	3.240	Struktura monolite betoni C 12/15	m3	13.0	13	169	1.300	16.9
28	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	307.0	12.8	3929.6	2.290	703.03
29	3.244	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25	m3	420.0	12.8	5376	2.290	961.8
Shuma 7:						9820.2		1712.45
8. PUNIME HEKUR BETONI 3								
30	3.287	F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm	ton	4.0	61	244	0.630	2.52
31	3.289	F V hekur betoni periodik, Ç- 5, Ø > 12mm	ton	1.0	42	42	0.630	0.63
Shuma 8:						286		3.15
9. PUNIME TE NDRYSHME								
32	3.618	FV Bordura betoni 20x35 cm	m	278.0	1.4	389.2	0	0
33	3.620	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m2	195.0	2.14	417.3	0	0
34	3.654/1	Furnizim, vendosje tuba plastmasi ø 80	m	202.0	0.25	50.5	0	0
Shuma 9:						857		0

10. ANALIZA TEKNIKE								
35	3.224/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m2	7599.0	0.082	623.118	0.015	113.985
Shuma 10:						623.118		113.985
11. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA								
36	3.164/2t	F.V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm	ml	74.0	1.78	131.72	0	0
37	3.935	F.v. Tabele rrethi "ndalim" e vogel me D = 40	copë	1.0	0.5	0.5	0	0
38	3.936	F.v. Tabela trekendore e vogel me A = 60	copë	3.0	0.5	1.5	0	0
39	3.941/5	F.v. Pervijues kthese e ngushte ose e forte(ne forme T)	copë	3.0	0.5	1.5	0	0
40	3.185	F.V guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W4	ml	278.0	1.74	483.72	0.30	83.4
41	3.925/1	F.v. Sinjalet e drejtimit urban HxL normal 25x125	copë	2.0	0.5	1	0	0
42	3.933	F.v. Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20	copë	1.0	0.5	0.5	0	0
43	3.934	F.v. Tabele rrethi "detyrim" e vogel me D = 40	copë	4.0	0.5	2	0	0
Shuma 11:						622.44		83.4
12. B. SINJALET HORIZONTALE								
44	3.943/3	Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 15 cm.Termoplastike (sprajt)	ml	3759.0	0.1	375.9	0.1	375.9
Shuma 12:						375.9		375.9
13. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESHE. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE								
45	3.949	Vizime me boje bikomponente	m2	31.0	0.1	3.1	0.50	15.5
Shuma 13:						3.1		15.5
14. LINJA T/L GERMIMI I GROPAVE TE SHTYLLAVE								
46	3.558	Spostim shtyllle elektrike (Cmontim dhe montim shtyllle elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret)	copë	3.0	12.2	36.6	2.70	8.1
Shuma 14:						36.6		8.1
SHUMA TOTALE						46564.2		7516.6

9 muaj x 22 ditë pune/ muaj = 198 ditë pune
198 ditë pune x 8 orë pune/ dita = 1584 orë pune
46564,2 orë totale punëtor / 1584 orë pune = 29.3 ≈ 30 punëtor
7516,6 orë totale makineri /1584 orë pune = 4.75 ≈ 5 manovrator/shofer
Në fuqinë punëtoare të kërkuar do pëfshihet dhe stafi inxhinierik.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë (Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë

pjesë të stafit të tij 1 (një) "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët Ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për mbarëvajtjen, ndërhyrjen, parandalimin dhe evitimin e situatave apo problematikave lidhur me rreziqet, sigurinë dhe shëndetin në punë, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë mbështetet edhe në dispozitat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", VKM nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", VKM nr.108, datë 09.02.2011 "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë. Në dispozitat e akteve të sipërcituara, ndër të tjera parashikohet se: punëdhënësi merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm; organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimit e punëmarrësit në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre; punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës; çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Pra, në dispozitat e akteve të mësipërme, përcaktohen kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik, emergjencë apo të papritura në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës, i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës, duke patur në fokus primar jetën dhe shëndetin e punonjësve të angazhuar me zbatimin e punimeve.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar muajin e fundit dhe të figurojë në listëpagesat e subjektit, punonjesit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Topograf
- 1 (një) Punëtor asfalti
- 1 (një) Elektriçist
- 1 (një) Hidraulik
- 2 (dy) Murator/suvatues
- 2 (dy) Betonues
- 1 (një) Pllakashtrues
- 1 (një) Hekurkthyes
- 1 (një) Saldator

- 2 (dy) Karpentier

Për punonjësit me profesionet si më sipër, ne menyre qe Autoriteti Kontraktor te kete mundesine e verifikimit, Operatoret Ekonomike duhet te plotesojne dhe ngarkojne tabelen e meposhtme me te dhenat e sakta qe i perkojne diplomes/certifikates se formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetore, te cilat regjistrohen ne bazen e te dhenave te AKPA-se prane Ministrise se Financave (Institucioni pergjegjes per formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzes/regjstrit dhe data e leshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (certifikatë/deshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqiperise.”
**(Per tekniket e mesem duhet te paraqitet diploma ose deftesa e perfundimit te shkolles se mesme profesionale).*
- Dëshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje trup certifikuese e akredituar ne Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Teknik Topograf është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve sipas kuotave dhe permasave ne projekt.

Punëtorë asfalti është i nevojshëm për shpërndarjen e asfaltit dhe binderit në rrugë. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 1 punëtorë asfalti.

Punonjes elektrikist prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve spostimit te linjave te tensionit te mesem e te larte qe pengojne zhvillimin normal te projektit dhe kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Punonjes hidraulik prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve spostimin e linjave te ujit te pijshem, spostimin e linjave te ujerave te zeza si dhe punime te tjera qe mund te dalin dhe lidhen me kete specialitet dhe kjo kërkesë përputhet

me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Punonjes murator/suvatues prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Punonjes pllakashtrues prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të shtrimit të pllakave në trotuare aty ku është parashikuar në projekt, vendosjen e bordurave anesore si dhe bordurave kufizuese dhe kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Punonjes hekurkthyes prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve prerjes së hekurit sipas permasive dhe pozicioneve të percaktuara në projekt, kthimin dhe konfigurimin e tyre sipas skicave të percaktuara në projekt dhe kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Punonjes saldator prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të saldimit dhe montimin e konstruksioneve metalike me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Punonjes Betonues prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të betonimit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Punonjes Karpentier prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të kalleperisë me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se ka të punësuar muajin e fundit dhe figuron në listëpagesat e subjektit, punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Eskavatorist/Manovrator – 2 (dy) punonjës
- Shofer – 2 (dy) punonjës

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimore dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Keta profesione janë të domosdoshem pasi sipas pikes 2.3.9 për të gjitha mjetet motorrike do të behet përdorimi i tyre nga keta specialist (ku theksohet që një drejtues mjeti mund të drejtojë disa mjete në kanter).

- **Eskavatorist/Manovrator** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit dhe afatit të punimeve rezultojnë të nevojshëm 2 manovratorë.
- **Shoferët** janë të nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zberthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 2 shoferë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për stafin mbështetës të kërkuar në objekt, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Nëpërmjet këtij stafi, synohet realizimi i objektit të kontratës brenda afatit, normave dhe me cilësi sipas standardeve në fuqi. Staf mbështetës është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.9 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nr	Lloji i Makinerive	Njesia	Sasia	Statusi
1	Eskavator me zinxhir	Copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Minieskavator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Fadrome me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5 – 12 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera

7	Kamionçine me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton	Copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Vibrator betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qera
9	Grejder me goma	Copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Rrule gome hekur	Copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Auto Betoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Autopompe Betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Autovinc	Copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Kompresor	Copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Saldatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Autobot uji me sprucator	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Matrapik	Copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Depozita uji 5000 l	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Asfaltoshtuese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Rrule hekur hekur	Copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Betoniere/motobetoniere	Copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Total Station	Copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Kokore	Copë	40	Në pronësi ose me qera
25	Jelek	Copë	40	Në pronësi ose me qera
26	Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili	Copë	1	Në pronësi ose me qera
27	Komplet i ndihmës së shpejtë	Copë	2	Në pronësi ose me qera
28	Tabela paralajmeruese	Copë	5	Në pronësi ose me qera
29	Karroca dore	Copë	3	Në pronësi ose me qera
30	Fabrike Asfaltbetoni e pajisur me QKL	Copë	1	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi
31	Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL	Copë	1	Pronësi /me qera/Kontrate furnizimi
32	Mini damper per transport betoni	Cope	1	Në pronësi ose me qera
33	Mini fadrome per ngarkim	Cope	1	Në pronësi ose me qera
34	Kontenier (Zyre e Levizeshme)	Cope	1	Në pronësi ose me qera

- a) Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (Çertifikatë Pronësie e mjetit nëse nuk është pajisur me lejen e re të qarkullimit), leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit Teknik (te vlefshme), siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (Çertifikatë Pronësie e mjetit nëse nuk është pajisur me lejen e re të qarkullimit), leje qarkullimi, çertifikaten e kontrollit Teknik (te vlefshme), siguracionin e mjetit (te vlefshme), çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për të tretë (e vlefshme) duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerave e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontrates

objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- c) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjete dhe targa e tij.
- d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.
- e) Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikoje dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.
- f) Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera,(Deklarate nga Administratori i Shoqerise Ofertuese).

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.9 duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje**).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:

- Eskavator me zinxhir duhet per te kryer punimet ne pjesen hyrese te fshatit ku ka nje terren shkembor dhe te veshtire dhe ky mjet eshte i pershtatshem per keto lloj terenesh.
- Minieskavator duhet ne pjesen brenda fshatit pasi ka zona te ngushta dhe mjetet e tjera nuk kryejne pune pasi nuk te lejojne muret rrethuese te shtepive.
- Eskavator me goma duhet per punimet ne pjesen ku lidhet rruga me rrugen nacionale dhe per arsye se rruga nacionale se fundmi eshte shtruar dhe rikonstruktuar ne menyre qe kjo te mos demtohet duhet ky lloj mjete.
- Fadrome me goma duhet per punimet ne pjesen ku lidhet rruga me rrugen nacionale dhe per arsye se rruga nacionale se fundmi eshte shtruar dhe rikonstruktuar ne menyre qe kjo te mos demtohet duhet ky lloj mjete pasi ky mjet sherben dhe per shkarkimin e te gjitha materialeve si pllaka bordura etj.
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 12 ton duhet per transportin e materialeve dhe te gjitha mbeturinave qe dalin gjate punes ne pjesen me te madhe te rruges ku tereni eshte i pershtatshem per keta lloj kamionash.
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5 – 12 ton duhet per punimet qe do te kryhen ne pjesen hyrese ne fshat ku hapësira eshte me e kufizuar dhe keto mjete jane me te pershtateshme ne keto hapësira.
- Kamionçine me kapacitet mbajtes deri 3.5 ton duhet per punimet brenda fshatit ku hapësirat jane te ngushta dhe nuk ka mundesi per te punuar kamionat me tonazh me te larte.
- Vibrator betoni per ngjeshjen e betonit dhe kryerjen e punimeve sipas kushteve teknike ne fuqi.
- Grejder me goma duhet per hapjen dhe nivelimin e shtresave te rruges sipas projektit.
- Rrule gome hekur duhet per ngjeshjen e shtresave rrugore dhe te kasonetes.
- Auto Betoniere duhet per transportin e betonit nga fabrika ne objekt ne menyre qe betoni te vije sipas kushteve teknike te zbatimit.

- Autopompe Betoni duhet per hedhjen e betonit ne vendet ku eshte e pa mundur te shkoje betoniera dhe mjetet e tjera dhe ky mjet e kryen kete proces.
- Autovinç duhet pasi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe konsiston ne ngritjen e materialeve te renda sipas kerkesave dhe nevojave te projektit.
- Kompresori duhet per punime shkembore ne zona te ngushta dhe eshte e pa mundur qe punimet te kryhen me mjetet e tjera qe ka ne dispozicion.
- Saldatrice per kryerje e punimeve te saldimit qe mund te paraqiten ne objekt.
- Autobot uji me sprucator duhet per sperkatjen e shtresave rrugore ne menyre qe punimet te kryhen sipas kushteve teknike.
- Betoniere/motobetoniere duhet per pergatitjen e sasive te vogla te betonit si dhe per pergatitjen e llacit per punimet qe do te kryhen ne objekt.
- Matrapik per punime germimi ne zona te ngushta ku terreni eshte shkembor dhe nuk mund te kryhet me mjete te tjera.
- Depozita uji 5000 l duhet qe te mbaje sasin e nevojshme te ujit per kryerjen e te gjitha punimeve ne rruge.
- Autobitumatrice duhet per sperkatjen e shtresave rrugore me prajmer sipas kushteve teknike te projektit.
- Asfaltoshtuese duhet per hapjen e shtresave te asfaltit sipas kushteve teknike te projektit.
- Rrule hekur hekur duhet per ngjeshjen e shtresave te asfaltit sipas kushteve teknike te projektit.
- Total Station duhet per piketimin e objektit hedhjen e kuotave te shtresave ne rruge etj.
- Kokore, Jelek, Fikse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secili, Komplet i ndihmës së shpejtë Keto paisje jane te domosdoshme ne kantier per sigurine e punonjesve te ndryshem, per dallimin e tyre dhe ne raste emergjente fiksja e zjarrit se bashku me kutine e ndihmes se shpejte.
- Tabela paralajmeruese duhet per te rregulluar trafikun ne rruge gjate periudhes se punimeve qe te shmangen aksidentet e mundshme, per orientimin dhe palajmerimin ne kantier per punimet qe po kryejne.
- Karroca dore duhet per transport materialesh ne sasi te vogla gjate proceseve te punes.
- Fabrike Asfaltbetoni e pajisur me QKL duhet per prodhimin e asfaltit dhe te betonit sipas kushteve teknike.
- Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL duhet per prodhimin e inerteve sipas kushteve teknike.
- Mini damper per trasport betoni duhet per transportin dhe hedhjen e betonit ne zona te ngushta dhe ku nuk mund te shkoje asnje mjet tjetër.
- Mini fadrome per ngarkim duhet per ngarkimin e betonit ne minidamper dhe transportin e tij ne zona te veshtira per mjetet e tjera.
- Kontenier (Zyre e Levizeshme) duhet per mbajtjen e gjithë dokumentacionit dhe gjithë proceset ndihmese ne kantier.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e punimeve, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i mjeteve, makinerive e pajisjeve të cilat duhet të disponohen nga OE në një të njërit prej formave të kërkuara, janë vlerësuar si të nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin

kapacitetet teknike sa i përket disponimit të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, e për këtë qëllim janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave të përcaktuara. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve dhe mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e punimeve objekt kontrate, janë marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në manualin e çmimeve në fuqi, si dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- **Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

- **Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

- **Çertifikatën për sistemimin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2023 (e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

- **Çertifikatën për sistemin e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor BS ISO 39001:2012(e vlefshme)** ose ekuivalente e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

ISO 39001:2012 Kjo çertifikatë mundëson që kompanitë të punojnë me sistemet e qarkullimit rrugor, të reduktojnë dhe të përjashtojnë rreziqet e humbjes të jetes dhe plagosjeve në lidhje me aksidentet gjatë procesit të punës.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.11 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

Argumentimi: Duke qenë se në preventiv kemi kryerjen e punimeve të ndryshme dhe transportin e tyre në venddepozitimet e miratuara, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njëësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B) sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto licenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3.12 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës në tender së bashku me preventivin duhet të dorëzojnë analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Bazuar në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nga njësia e prokurimit.

- U diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe u bë miratimi i dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë **data 23.12.2024, ora 11⁰⁰, vendi: në mënyrë elektronike në www.app.gov.al** .

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT

MIRATOI
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Alma HOXHA